





Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Beledijesi

DATE/A:	15.01.2025
PËR:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
CC:	Sulltan Badalli, Drejtor i DBF Simir Krasniqi, Drejtor i DSH Adem Morina, Drejtor i DKRS Bexhat Bytyqi, Drejtor i DB Isa Osmankaj, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
NGA:	Agron Hoxha, Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm 
TEMA/ LËNDA:	RAPORTI I MONITORIMIT TE PROGRESIT TE ZBATIMIT TË REKOMADIMEVE TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR KOMUNËN E PRIZRENIT PËR PERIUDHEN JANAR-DHJETOR 2024

**MONITORIMI I PROGRESIT TE ZBATIMIT TË REKOMADIMEVE TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË
BRENDHSËM PËR KOMUNËN E PRIZRENIT PËR PERIUDHEN JANAR-DHJETOR 2024**

Nga shtatë (7) raportet e auditimit të përfunduar deri me 31.12.2024, janë dhënë gjithsej 19 rekomandime. Përmes procesit të monitorimit të rekomandimeve gjatë vitit sipas periudhave të caktuara në PV dhe nga rishikimi ynë në janar 2025, kemi konstatuar se janë zbatuar 12 rekomandime apo 63%, 3 apo 16% në proces, si dhe 4 apo 21% nuk janë zbatuar. Për periudhën raportuese 2 nga 4 rekomandime konsiderohen të pa zbatuara, pasi që afati i dhënë për zbatimin e tyre në PV nga drejtorit përkatëse përfshinë përudhen e parë të vitit 2025.

Më poshtë kemi paraqitur në formë tabelore rekomandimet e dhëna, afati për zbatimin e tyre, veprimet që janë ndërmarrë, përgjegjësit dhe statusi zbatimit/mos-zbatimit dhe rekomandimeve që janë në proces të zbatimit.

REKOMANDIMET	DATA E RAPROTIT (PËRFUNDIMI)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMADIMEVE				
					I ZBATUAR	PJESËRISHT I ZBATUAR		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatim në proces		
<p>Emërtimi i auditimit: Zbatimi i procedurave lidhur me identifikimin, evidentimin, klasifikimin, barazimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së Komunës në regjistrat e pasurisë</p> <p>Rekomandimi 1: Zyrtari i pasurisë duhet që të harmonizoj regjistrin e pasurisë jo financiare duke regjistruar në regjistrat e pasurisë të gjitha pasuritë të cilat i plotësojnë kriteret e pasurisë jo financiare në mënyrë që të evitohet mbi/nën vlerësimi i pasurive komunale e cila më pas reflektohet edhe në RVF.</p>	01 Mars 2024	Prill-Maj 2024	ZP	Janë ndërmarr veprimet e duhura – dëshmi regjistri i pasurisë	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Rekomandimi 2: Zyrtari i pasurisë duhet që të shtojë kontrollin dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale të cilat i plotësojnë kushtet që pasuria të jetë në përdorim, duhet që ta mbyllë llogarinë e investimeve në vijim në regjistrat kontabël dhe më pas të fillojë edhe procedura e zhvlerësimit të këtyre pasurive.		Prill-Maj 2024	ZP	Janë ndërmarr veprimet është formuar grupi punues me anëtar të të gjitha drejtorive, Sa i përket vitit 2024, investimet ne vijim janë te mbyllura.	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Rekomandimi 3: Komisioni i emëruar I inventarizimit pa marrë parasysh vështirësitë teknike që dalin gjatë procesit, duhet që me efikasitet më të shtuar të përfundojnë inventarizimin brenda afateve kohore që më pas të ketë edhe kohë të mjaftueshme për harmonizimin e regjistrave të pasurisë me regjistrin e inventarizimit.		Dhjetor 2024-Janar 2025	Komisioni për inventarizim	Është i zbatuar në tërësi pasi qe me kohë do të dorëzohet raporti për Inventarizimin e Pasurisë Komunale. Deri në kohen e rishikimit janë dorëzuar të gjitha raportet individuale nga anëtarët e komisionit dhe jem në fazën e përgatitjes se raportit të përgjithshëm	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

REKOMANDIMET	DATA E RAPROTIT (PËRFUNDIMI)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
				I ZBATUAR	PJESËRISHT I ZBATUAR		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
					Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në proces		
Emërtimi i auditimit: Auditimi i të hyrave vetanake në drejtorinë e shëndetësisë	17 Prill 2024	Gjatë vitit 2024	Janë ndërmarr veprimet e duhura, është marrë interpretim nga MSH e cila ka sugjeruar që deri në rishikim të rregullores për taksa të përdoren tarifa sipas vendimit të KD të QKMF	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Rekomandimi 1: Drejtoria e Shëndetësisë duhet që vendimet që kanë të bëjnë me përcaktimin e taksave (të cilat konsiderohen të hyra vetanake) ti inkorporojnë në Rregulloren Taksa Komunale në mënyrë që të marrë formë ligjore								

REKOMANDIMET	DATA E RAPROTIT (PËRFUNDIMI)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
					I ZBATUAR	PJESËRISHT I ZBATUAR		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në proces		
<p>Emërtimi i auditimit: Rregullsitë lidhur me kalkulimin e detyrimeve dhe grumbullimin e të hyrave nga Tatimi në Pronë</p>	24 Maj 2024	31.12.2024	Jeton Jelliqi	Janë ndërmarr veprimet e duhura, si: janë identifikuar pronat dhe parcelat të cilat janë në pronësi të kuvendit komunal, janë krijuar lista dhe në vazhdimësi jemi duke i korrigjuar.	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<p>Rekomandimi 1: Menaxhmenti i tatimit në pronë edhe pse nuk ka vendimmarrje të drejtpërdrejtë në rastin e ngarkesave me tatim në pronë, duhet që të identifikojë të gjitha pronat të cilat sipas ligjit 06/L-005 lirohen nga tatimi në pronë dhe të njoftoj departamentin e tatimit në pronë që të mos i faturojë në të ardhmen më këto prona.</p>					<p>Rekomandimi 2: Menaxhmenti i tatimit në pronë duhet që sa më parë të filloj dhe ti identifikojë procedurat e qarta në mbledhjen e borxheve, duke përgatitur një plan veprimi duke përcaktuar veprimet dhe ti përcaktoj afatet për realizim. Të shqyrtojë të gjitha opsionet e mundshme për inkasimin e borxheve në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.</p>	31.12.2024	Jeton Jelliqi	Pas hyrjes në fuqi të manualit për inkasim te detyrueshëm ne si zyre e tatimit në pronë kemi marrë këto hapa: Letër kujtesa 25 Njoftime përfundimtare 12 Ekzekutime te vendimeve para bllokimit te llogarisë 2 Bllokime te llogarisë 2	<input type="checkbox"/>

REKOMANDIMET	DATA E RAPROTIT (PËRFUNDIMI)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDMËRRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
					I ZBATUAR	PJESËRISHT I ZBATUAR		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në proces		
<p>Emërtimi i auditimit: Menaxhimi i shpenzimeve për mallra & shërbime dhe komunalit në administratën komunale (pa arsimin dhe shëndetësinë)</p> <p>Rekomandimi nr.1 (I rëndësisë së mesme): Menaxhmenti duhet të ndërmarrë masa në drejtim të forcimit të kontrollit të brendshëm, në mënyrë që shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve të realizohen në përputhje me kërkesat ligjore të parapara dhe rregulloret e thesarit për shpenzimin e parave publike.</p>	28 qershor 2024	Dhjetor 2024	DEF	Janë ndërmarrë masa të mjaftueshme nga ana e menaxhmenti në lidhje me shpenzimin adekuat sipas kategorive	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<p>Rekomandimi nr.2 (I rëndësisë së mesme): Udhëheqësit e njësive kërkuese, zyrtari/ja për zotimin e fondeve , ZKF dhe zyrtarët e prokurimit duhet që të sigurohen që iniciimi dhe procesi i pagesave të bëhet sipas hapave të përcaktuar në nenin 22 të rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike;</p>		Shtator 2024	DEF	Janë ndërmarrë masa të mjaftueshme nga ana e menaxhmenti në lidhje	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<p>Rekomandimi nr.3 (I rëndësisë së lartë): Menaxhmenti i drejtorive të cilat kanë obligime financiare të papaguara dhe ZKF duhet që të mos lejojnë tejkalimin e afatit të paraparë ligjor në mënyrë që të shmangin shpenzimet shtesë për procedurat përmbare.</p>		Shtator 2024	Drejtorit përkatëse ku janë theksuar të gjeturat	Janë njoftuar të gjitha drejtorit për tejkalimin e afatit të pagesave sipas ligjit dhe këtë vit ka hapa konkret ne zvogëlimin e pagesave te cilat tejkalojnë afatin ligjor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

<p>Rekomandimi nr.4 (I rëndësisë së mesme):</p> <p>Menaxhmenti i drejtorive përkatëse duhet që gjatë planifikimit të buxhetit për një projekt të caktuar i cili mund të zgjasë disa vite, fondet e planifikuara për financimin e projekteve të vlerësojnë në mënyrë sa më të saktë dhe sipas kriterëve të përcaktuara në planin kontabël, apo në rastet kur planifikimet nuk janë në kategorinë përkatëse të bëhet ridestini i mjeteve në kodet e caktuar ekonomike.</p>		Korrik 2024	Drejtorit përkatëse ku janë theksuar të gjeturat	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme nga menaxhmenti	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	√	<input type="checkbox"/>
---	--	-------------	--	---	--------------------------	--------------------------	--------------------------	---	--------------------------

REKOMANDIMET	DATA E RAPROTIT (PËRFUNDIMI)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
					I ZBATUAR	Zbatimi në proces		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në proces		
<p>Emërtimi i auditimit: Auditimi i subvencioneve dhe transfereve 2024 në Drejtorinë e Bujqësisë</p> <p>Rekomandimi nr.1 (I rëndësisë së mesme): Udhëheqësit e Drejtorisë së Bujqësisë duhet të aplikojnë në tërësi nenet e rregullores komunale për subvencionim, në mënyrë që të shmangë çdo anashkalim të kriterëve obligative të cilat rregullojnë procedurën e subvencionimit përmes fondeve publike.</p>	30 gusht 2024	31 tetor 2024	Zyrtarët e drejtorisë së bujqësisë	Janë ndërmarrë masa te mjaftueshme nga ana e menaxhmentit. Në thirrjet për subvencione në drejtorinë janë duke u respektuar afatet kohore sipas rregullores komunale për subvencione.	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<p>Rekomandimi nr.2 (I rëndësisë së mesme): Drejtorja e Bujqësisë me rastin e përgatitjes së marrëveshjes/kontratës me përfituesit duhet që ti përmbahet neneve të rregullores komunale për subvencionim të cilat e përcaktojnë qartë se çka duhet të përmbajë një marrëveshje apo kontratë, në mënyrë që të shmangë çdo situatë jo të favorshme e cila potencialisht mund të ndodhë.</p>		31 tetor 2024	Zyrtarët e drejtorisë së bujqësisë	Nga dhënia e rekomandimit nga ana e AB ne kemi respektuar kërkesën ligjore të përcaktuar në rregullore të cilat rregullojnë marrëveshjen në mes të komunës dhe përfitueseve (fermerëve)	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

REKOMANDIMET	DATA E RAPROTIT (PËRFUNDIMI)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
					I ZBATUAR	Zbatimi në proces		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në proces		
<p>Emërtimi i auditimit: Pajtueshmëri në proceset e prokurimit për kontratat me vlerë të vogël, të mesme dhe të mëdha</p> <p>Rekomandimi nr.1 (I rëndësisë së mesme): Zyra e prokurimit duhet që të ndërmarrë veprime të nevojshme që të përcaktojë të paktën kriteret minimale për procedurat e prokurimit, të cilët duhet të jenë të matshme, me qëllim të përzgjedhjes së operatorit ekonomi të përgjegjshëm sepse mos caktimi i kërkesave të tilla mund të ndikojë në përzgjedhjen e operatorëve të papërgjegjshëm ekonomik</p>	1 nëntor 2024	31.12.2024	Isa Osmankaj	Zyra e Prokurimit do të ketë kujdes të shtuar në të ardhmen lidhur me përgatitjen e dosjes së tenderit duke pas parasysh vlerën e parashikuar të projektit do të vendosë edhe kriteret të cilat janë të matshëm dhe në harmoni me natyrën e projektit.	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<p>Rekomandimi nr.2 (I rëndësisë së mesme): Udhëheqësi i zyrës së prokurimit duhet që të respektojë afatet kohore për procedurat e vlerësimit të tenderëve të përcaktuara në rregulloren 001/2022, gjithashtu duhet të krijoj një mekanizëm të monitorimit të rregullt lidhur me procesin e vlerësimit të tenderëve nga ana e komisioneve të vlerësimit, me qëllim të parandalimit të vonesave eventuale në të ardhmen</p>		31.12.2024	Isa Osmankaj	Fill pas hapjes së ofertave, nga zyra e Menaxheri i prokurimit propozohen emrat e komisionit të vlerësimit për secilin projekt, ku pastaj nga Kryetari aprovon përbërjen e këtij komisioni. Nga ai moment kur Vendimi i nënshkruar sillet si i tillë tek ne, Përgjegjësi i Prokurimit cakton një zyrtar nga zyra i cili ka për obligim të njoftoj anëtarët e komisionit dhe ti thërras të njëjtit që sa më parë të jetë e mundshme të vijnë në zyrën e Prokurimit për të bërë vlerësimin e ofertave për atë projekt.	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

				Vonesa eventuale mund të ketë vetëm për arsyt e pushimeve nga ndonjëri prej anëtarëve të komisionit ose për ndonjë arsye tjetër të cilat do ti paraqes ky komision. Do të kujdesemi që mos ë ketë vonesa jashtë afateve ligjore të parapara për vlerësim të ofertave.					
Rekomandimi nr.3 (I rëndësisë së lartë): Komisionet vlerësuese dhe Udhëheqësi i Prokurimit duhet të zbatojnë një proces rigoroz dhe të saktë të verifikimit të dokumenteve të paraqitura nga ana e OE me kriteret e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, për të garantuar që fitues të shpallet vetëm ai OE që përmbush të gjitha kriteret e përcaktuar ligjor. duhet që tu përmbahet kriterëve të vendosura nga vetë AK në mënyrë që të përzgjidhen operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë kriteret.		31.12.2024	Isa Osmankaj	Kujdes të shtuar do të kemi në punën e komisioneve për vlerësim duke i furnizuar ata me të gjithë materialin e ofruar nga Operatorët ekonomik si dhe duke insistuar tek këta anëtarë që vlerësimin ta bëjnë në përputhje të plotë Me Rregullat e parapara me LPP dhe rregulloren në fuqi për prokurim publik.	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Rekomandimi nr.4 (I rëndësisë së mesme): Udhëheqësi i zyrës së prokurimit duhet të siguroj që asnjë kontratë publike të mos nënshkruhet pa u zotuar fondet e ndara në buxhetin e vitit përkatës.		31.12.2024	Isa Osmankaj	Çështja e zotimit të mjeteve është temë e cila diskutohet gati në çdo auditim që i bëhet procedurave të, Prokurimit, Do të kujdesemi sa më shumë që është e mundur që kontratat mos ë nënshkruhen pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve. Është shumë në interesin e zyrës së Prokurimit që me rastin e nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjaftueshëm i mjeteve, përndryshe zyra e Prokurimit nuk	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	√	<input type="checkbox"/>

REKOMANDIMET	DATA E RAPROTIT (PËRFUNDIMI)	AFATI I IMPLEMENTIMIT	PËRGJEGJËSIT	VEPRIMET QË JANË NDËRMARRË	PROGRESI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE				
					I ZBATUAR	PJESËRISHT I ZBATUAR		I PAZBATUAR	NUK APLIKOHET
						Faza fillestare e zbatimit	Zbatimi në proces		
<p>Emërtimi i auditimit: Auditimi i shpenzimeve në kategorinë e investimeve kapitale në administratën e përgjithshme të komunës (duke përfshirë të gjitha drejtoritë e komunës)</p> <p>Rekomandimi nr.1 (I rëndësishëm së mesme): Udhëheqësit e drejtorive duhet që paraprakisht të sigurohen se ka fonde të mjaftueshme për pagesën e faturave dhe më pas të bëjnë zotimin e fondeve, po ashtu edhe urdhër blerjen ta krijojnë para pranimit të faturave</p>		Prill 2025	Drejtorët e drejtorive	Janë njoftuar të gjitha drejtoritë për buxhetin të cilin e kanë në dispozicion për çdo kategori ekonomike, posaçërisht edhe për investime kapitale.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	√	<input type="checkbox"/>
<p>Rekomandimi nr.2 (I rëndësishëm së lartë): Menaxherët e kontratave duhet të sigurojnë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë në mënyrë që të shmangin vonesat e panevojshme.</p>	27 dhjetor 2024	28.03.2025	Ejup Kryeziu dhe Laura Suka	<p>Për kontratën me nr: 622-22-11274-5-1-1 "Ndërtimi i rrugës tranzitore – kryqëzim me autostradën" mundem të ju them si ne vijim: Projekti thuajse ka përfunduar në tërësi dhe se për të njëjtin edhe është bërë kërkesa pranim teknik e datës 18/12/2024 me të vetmin qellim që të përfundojnë – kompletohen të gjitha punimet dhe të përfundoj projekti në tersi. Duke u bazuar në stinën dhe motin e papërshtatshëm për të zhvilluar punimet e mbetura (stina e dimrit) ,si dhe aktivitetet e mbyllura për punime mundem te ju them se proiekti do te</p>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	√	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

				përfundoj përafërsisht nga përfundimi I muajit mars ,gjithmonë duke u bazuara ne kushtet klimaterike.					
Rekomandimi nr.3 (I rëndësisë së mesme): Udhëheqësit e drejtorive, ZKF dhe zyrtarët tjerë përgjegjës duhet që para çdo obligimi të zotojnë fillimisht mjetet financiare dhe të mos lejojnë që të ketë tejkalime të afateve ligjore për pagesën e faturave që më pas do të rezultonte me pagesë përmbartimore e cila do i rriste shpenzimet e pa planifikuara		Maj 2025	Drejtoret e drejtorive	Janë njoftuar të gjitha drejtorit për tejkalimin e afatit të pagesave sipas ligjit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	√	<input type="checkbox"/>

Total statusi i rekomandimeve (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar/në proces ose i pa zbatuar) për të gjitha rekomandimet për periudhën janar- dhjetor 2024

Total	Gjithsej:19 Të zbatuara: 12 Pjesërisht/proces: 3 Të pazbatuara: 4
--------------	--

Agron Hoxha

Udhëheqësi i Auditimit të Brendshëm

